**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A**
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**
**SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE**

Nr._________Prot. Tiranë, më ___/___/2019

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatori ekonomik "CIVIL CONS" shpk me NIPT L81315015O, me administrator Z. Korab Aliko, me seli në Adresën: Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr 9, Rruga Don Bosko, Pallati 10 (Shekulli), Hyrja A, Ap 66, Zyra 1.

**Lloji i procedurës se prokurimit:** "Procedurë e hapur"

**Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:**"Mbikqyrja e punimeve të ndërtimeve dhe rikonstruksioneve të rrjetit të Ujësjellës Kanalizimeve për UKT sh.a. (Faza I)"

**Fondi Limit:** 18.771.284 (tetëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**Numri i referencës së procedurës**: REF-24754-05-30-2019.

**●Loti i gjashtë**: "Mbikqyrja e punimeve për objektin: "Ndërtim tepërplotësi dhe shkarkuesi në Depot e Tiranës" me fond limit 524.909 (pesëqind e njëzet e katër mijë e nëntëqind e nëntë) lekë pa TVSH.

Numri i referencës së procedurës/lotit 6 REF-24790-05-30-2019

**Për Lotin e gjashtë afati**: Mbikqyrja e punimeve për objektin: "Ndërtim tepërplotësi dhe shkarkuesi në Depot e Tiranës" – 2 muaj duke nisur nga data e dorëzimit te sheshit të punimeve.

**Data e zhvillimit të tenderit është:** 04.07.2019 Ora: 11:00

**Buletini i Njoftimeve Publike**: Nr. 22 DATE 03.06.2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik **“REAN 95” shpk** NIPT-i L61827043V
   Vlera: 484,531 (katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë pa tvsh..

2. Operatori Ekonomik **“NOVATECH STUDIO” SHPK** NIPT-i L01717030C
   Vlera: 484.532 (katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh.

3. Operatori Ekonomik **“XH & MILER” shpk** NIPT-i K72105003E
   Vlera: 484.532 (katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh.

4. Operatori Ekonomik “**CIVIL CONS” SHPK** NIPT-i L81315015O

   Vlera**:** 444,154.02 (katërqind e dyzetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër presje zero dy) lekë pa tvsh.

**Të skualifikuar:**

1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik **“REAN 95” shpk** me vlerë të ofertës 484,531 (katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

**Së pari** AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

b. Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik konstatohet se operatori ekonomik Rean 95 sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë **deklaratën për paraqitje oferte të pavarur**, sipas Shtojcës 1/1 çka bie në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik si dhe kushteve të veçanta të kualifikimit të përcaktuar në DST.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik “Rean 95” shpk nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në DST.

Referuar ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 41, pika 1, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike”, si edhe Seksionit II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 1.1. të dokumentave të tenderit ku është përcaktuar: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

**Në shtojcën 9 shprehimisht përcaktohet se**…. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” në të cilën citohet se …Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme per te percaktuar oferten fituese ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentat e tenderit.

Pra,përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që

gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë jane të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

**Komisioni I Vlerësimit Të Ofertave Nga Shqyrtimi I Kësaj Oferte Në Mbështetje Të Nenit 53 Pika 5, Të Ligjit Nr. 9643, Datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" (I Ndryshuar) Dhe Vendimit Të Këshillit Të Ministrave Nr. 914, Datë 29.12.2014 "Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik", Kreu Vii,Neni 66 Pika 3, E Shpall Të Pavlefshme Këtë Ofertë Pasi Nuk Plotëson Kërkesat E Përcaktuara Në Dokumentet E Tenderit.**

**2.** Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik **"XH & MILER"sh.p.k** me vlerë të ofertës **484.532** (katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e peseëqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", ( i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë vijon:

***Së pari*** AK ka kërkuar në kriteret e pergjithshme të kualifikimit **(deklaratën mbi plotësimin e kritereve të përgjithshme ..**

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik KVO konstaton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë deklaratën mbi plotësimin e kritereve të përgjitshme pjesë e dokumentave standarte të tenderit.

KVO konstaton gjithashtu se, nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.

Prandaj, operatori ekonomik "XH&MILER" shpk duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Neni 53/2 I LPP percakton qarte se , nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII,Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, Operatori ekonomik "CIVIL CONS" shpk me NIPT L81315015O, me administrator Z. Korab Aliko, me seli në Adresën: Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr 9, Rruga Don Bosko, Pallati 10 (Shekulli), Hyrja A, Ap 66, Zyra 1, me vlerë të ofertës: **444,154.02 (katërqind e dyzetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër presje zero dy)lekë pa tvsh**, **se është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet

sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.07.2019

**Ankesa:** Nuk ka patur.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**REDI MOLLA**